



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**  
**DURRES**

**Numri i Çështjes** 71041-02825-11-2019      **Data e Regjistrimit** 11/4/2019  
**Numri i Vendimit** 11-2020-1314      **Data e Vendimit** 3/30/2020

**VENDIM**  
**NE EMER TE REPUBLIKËS**

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRES E PERBERE NGA:**

**KRYESUES:** Eda Kaja

**ANËTAR**

**SEKRETARE** Mimoza Cani

**Objekti:** Heqjen e sekuestros se vendosur mbi llogarite bankare te shtetasit \*\*\*\*\*  
Elez Kortoci, me vendimin date 26.10.2017 te Prokurorise prane \*\*\*\*\*  
se Rrethit Gjyqesor Durres.

**Baza Ligjore :** Nenet 212 e 217 te K.Pr.Penale

**Përmbledhja e vendimit:**

Në seancën gjyqësore të datës 26.02.2020, të zhvilluar në prani të, kerkuesit mbrojtësit së zgjedhur prej kerkuesit, Av.Etleva Sherifi, Prokuror Ndriçim Troplini gjykata pasi shqyrtoi në tërësi rrethanat e çështjes, çmoi dhe vlerësoi në tërësi provat e marra deri tani në seancë gjyqësore nënshtruar rregullave të gjykimit si dhe dëgjoi kërkesat e palëve, të cilat kërkuar:

**Kërkuesi:**

- Heqjen e sekuestros se vendosur mbi llogarite bankeare te shtetasit \*\*\*\*\*  
Elez Kortoci me vendimin date 26.10.2017 t Prokurorise prane \*\*\*\*\*  
e Shkalles se Pare Durres.

\*\*\*\*\* :

- Rrëzimin e kerkeses.

Vëren:

*Drejtoria për Hetimin e Krimin Ekonomik e Financiar, ne Drejtorine Vendore te Policise Durres, shkresen nr. 4137 prot., date 25.10 2017, ka referuar materialet hetimore per vepren penale "Pastrimi i produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale", te parashikuar nga neni 287 i K. Penal ne ngarkim te shtetasit Ramë Elez \*\*\*\*\**

Nga verifikimet e bera ka rezultuar se ky shtetas ka disa transaksione bankare ne Banken Intesa Sanpaolo Tirane-Shqiperisi me poshte:

- Me date 19.09.2013 ka terhequr shumen 9 930 Gbp.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**  
**DURRES**

- Me date 31.07.2017 ka terhequr shumen 30 000 Gbp si shpenzime per restaurim.
- Me date 11.08.2017 ka terhequr shumen 18 000 Gbp si shpenzime per restaurim.
- Me date 21.09.2017 ka terhequr shumen 20 000 Gbp per rikonstruksion shtepie,

Duke marre ne konsiderate terheqjet ne cash dhe ne vlera te konsiderueshme ne banken Intesa Sanpaolo, per kete shtetas ka rezultuar se shtetasi \*\*\*\*\* Kortoci mban llogari prane bankes qe prej Gushtit 2015 ne monedhen Paund Britanik.

Ne Llogarine e tij jane kryer trasnfertat si me poshte:

Ne date 28.06.2017 vlera GBP 40 000

Ne date 17.07.2017 vlera GBP 8 977.5

Ne date 25.07.2017 vlera GBP 48100

Ne date 04.09.2017 vlera GBP 50 000

Ne date 18.09.2017 vlera GBP 74 960

Nga historiku i kesaj llogarie rezulton se ato kane ardhur si rezultat I transfertave ne llogarine e tij nga shtetasi Lonard Valbona, Angli, me detaje "valbona". Ai ka deklaruar se Lonard Valbona eshte nipi i tij (djali i motres) i cili eshte si permarrës ndertimesh ne Angli dhe se prinderit e tij jane ne moshe dhe prandaj Lonardi ia dergon atij fondet.

Ne kete llogari jane kryere dhe terheqje nga kjo llogari me pershkrim shkollim per femijet, restaurim shtepie etj. Me pershkrim restaurim shtepie ka kryer 3 terheqje ne vlere totale 68 003 Gbp; Nderkohe qe pervec shtetasit Lonard Valbona ka perfituar transferta edhe nga Aferdita Ahmetaj dhe Demush Hasani; Ne date 11.08.2017 ka transferuar ne banken BKT shumen 40 000 Gbp.

Shtetasi \*\*\*\*\* Kortoci ka kerkuar te terheqe nga llogaria shumen 95 000 Gbp me qellim per ta investuar ne blerjen e geshtenjave, per te cilen nuk ka paraqitur asnje dokument. Profili i klientit eshte i vetepunesuar dhe nuk rezulton te jete i regjistruar ne QKB.

Shtetasi Ramë Elez \*\*\*\*\* ka disatransaksione bankare në llogarinë e tij dhe duke marrë në konsiderate tërheqjet në cash dhe në vlera të konsiderueshme, si dhe nga verifikimet nga historiku I kësaj llogarie rezulton se ato para kanë ardhur si rezultat I transfertave në llogarinë e tij nga



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**  
**DURRES**

shtetasi Lonard Valbona, Angli, me detaje “valbona” ku është deklaruar se shtetasi me gjeneralitete Lonard Valbona është Drejtori 2 (dy) shoqërive në Angli, konkretisht “Oakes Construction LTD” dhe “L&V Building Construction LTD”.

Nga verifikimet e bëra nga ana e policies ka rezultuar se shtetasi Lonard Valbona ka bërë ndryshime në gjeneralitete nga Lonard Sherif Valbona në Leonard Sherif Kuka.

Nisur nga fakti i mësipërm dhe deklarimi i bërë në bankë ka rezultuar se shtetasi Ramë Elez \*\*\*\*\* ka transaksione bankare dhe pasuri të dyshimta lidhur me burimin e krijimit të tyre .

Nga ana e kerkuesit Ramë Elez \*\*\*\*\* me datë 04.11.2019, është paraqitur në Gjykate kërkesa me objekt: Heqjen e sekuestros se vendosur mbi llogarite bankare te shtetasit \*\*\*\*\* Elez Kortoçi me vendimin date 26.10.2017 te Prokurorise prane \*\*\*\*\* e Shkalles se Pare Durres.

Gjykata shqyrtoi me kujdes të gjithë materialet e ceshtjes ku rezulton se me vendimin date 26.10.2017 te Prokurorise prane \*\*\*\*\* e Shkalles se Pare Durres eshte vendosur sekuestro mbi llogarite bankare te shtetasit \*\*\*\*\* Elez \*\*\*\*\* . Gjithashtu \*\*\*\*\* prane \*\*\*\*\* se Shkalles se Pare Durres, meqënëse ka dyshime të arësyeshme që mund të jenë konsumuar elementët e figures së veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i K.Penal, për ecurinë e mëtejshme të hetimeve të këtij procedimi penal, eshte kerkuar marrja e provave nga autoriteti kompetent ne Mbretërinë e Bashkuar (Angli), mbështetur në nenin 509/1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë dhe në Konventën e Këshillit të Europes “Për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale” në interes të këtij procedimi penal, por nga autoritet Angleze te drejtesise nuk ka asnje pergjigje.

Gjithashtu, nga pasqyrat financiare te paraqitura nga ana e kerkuesit Ramë Elez \*\*\*\*\* ne séance gjyqsore, provohet se shuma e transefruar ne vitin 2017 eshte 222.037 paund, eshte nje shume goxha e madhe per transeferte bankare per harkun e 4 muajve. Dokumentat e dorezuara privatisht nga shtetasi Leonard Kuka, jane paqyre finaciare 2015-2016, te shoqerise “L&V Building Construction LTD”, ku ky shtetas pretendon se eshte ortak ne Shumen e 50% teaksioneve, dhe fitimi vjetor i kesaj shoqerie per vitin 2015-2016 eshte 40.000 paund. Kjo shume nuk justifikon Shumen prej 222.037 paund tetransferuar ne vitin 2017.

Ne kushtet e mesiperme, Gjykata vlerson se, vendimi i dates 26.10.2017 qe ka vendosur sekuestron mbi llogarite bankare, eshte bere ne perputhje me nenin 274 te K.Pr.Penal ne te cilin citohet se:



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**  
**DURRES**

*" ...Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të 153 lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, ...*

*Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal.... "*

Gjithashtu gjykata, vleron se që nga momenti i venies se sekuestros nuk rezulton te kete ndryshim te kushteve te zbatimit te kesaj mase, per te urdheruar heqjen e sekuestros se vene me vendimin date 26.10.2017 te Prokurorise prane \*\*\*\*\* e Shkalles se Pare Durres.

Per shkaqet e mesiperme, Gjykata vlereson se kerkesa e bere nga kerkuesi Ramë Elez \*\*\*\*\* nuk është e mbështetur në prova dhe ligj e duhet rrëzuar.

**Për keto arsye:**

Baza Ligjore:

Ne zbatim të nenit nenet 274 e vijues te Kodit te Procedures Penale, Gjykata

Vendosi:

1. Rrëzimin e kërkesës së kërkuarit \*\*\*\*\* Kartoci, me objekt: Heqjen e sekuestros se vendosur mbi llogarite bankare te shtetasit \*\*\*\*\* Elez Kortoci, me vendimin date 26.10.2017 te Prokurorise prane \*\*\*\*\* se Rrethit Gjyqesor Durres, si të pa bazuar në prova dhe në ligj.
2. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të kërkuarit
3. Kunder vendimit mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit Durres brënda 15 (pesëmbëdhjetë) diteve nga e nesermja e shpalljes se tij.

Ky dokument është marrë nga [www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al). Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.